



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2023:252589

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05586675

C.nr. 1174/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani , duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.K nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit i përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 504.00 euro, jashtë seancës, më datën 17.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit M.K.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.K, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 360, ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 2.00 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 1.40, apo shumën e përgjithshme prej 504.00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 20.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit M.K nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit , t’i paguajë shumën prej 125,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M.K, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 20.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit të shpenyimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 504 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punojë si mësimdhënës në SH.M.L “Xhelal Hjada - Toni” në Rahovec, e që për periudhën e kërkuar paditësit nga data 21.01.2021 e deri me datën 21.11.2022 i ka takuar e drejta e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 21,01.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për paditësin M.K për 360 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 05.04.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësi nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave, për paditësin M.K: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 208/23 i datës 31,03.2023, i lëshuar nga SH.M.L “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec, për paditësin kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 201, e datës 22,09,2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit mars 2023, i lëshuar nga Knë Prizren për paditësin M.K.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në

punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon kompensimi për shpenzimet e udhëtimit si dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit mars 2023, i lëshuar nga K në Prizren për paditësin M.K, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Xërxë – Rahovec si dhe anasjelltas është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 208/23 i datës 31.03.2023, i lëshuar nga SH.M.L “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M.K, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 360 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 201, e datës 22.05.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit M.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.M.L “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi M.K në periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin tij të punës kanë prezantuar 360 ditë të punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*.

Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Në rast se shumëzohen 360 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1,40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 504.00euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 125,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

#### GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.1174/2023, më datën 17.04.2024

B.Profesionale  
Shpresa Haxhijaha Ramani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.